



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE ✓

Nr/882 prot.

Gramsh, më 29.05.2023

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
BRENDA SË NJËJTËS NJËSI ARSIMORE VENDORE**

Në zbatim të Ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (ndryshuar me Ligjin nr.48/2018); Urdhërin e MASR nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Institucioneve arsimore”, Udhëzimin nr. 12 datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësuesit për Shqipërinë”, Urdhërit Nr. 30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimorë në Institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar, Bashkia Gramsh shpall procedurat për lëvizje paralele brenda së njëjtës njësi arsimore vendore;

Afati për dorëzimin të dosjeve për të gjithë mësuesit e arsimit parashkollor të cilët dëshirojnë të kryejnë lëvizje paralele para fillimit të vitit shkollor 2023-2024,

01.06.2023-30.06.2023

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë bazuar në Udhëzimin e MASR nr.12, datë 10.06.2021 shtojca 2.1):

1. Kërkesë për lëvizje paralele;
2. Jetëshkrim, plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Nota mesatare e studimeve të larta (cikli I+II);
4. Kualifikimet shkencore në edukim;

5. Vlerësimi i komisionit psiko-social;
6. Vlerësimi i prindërve;
7. Vlerësimi nga eprori direkt, për dy vitet e fundit të punës;
8. Shkalla e kualifikimit;
9. Dëshmi, të njohjes së gjuhëve të huaja dhe kompjuterike;
10. Rezultati i arritur në testimin e mësuesve në sistem;
11. Botimet në ISBN Kumtesa, publikime (nëse ka);
12. Certifikata të akredituara.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë në Zyrën e Protokoll-Arkivit, Bashkia Gramsh, brenda dates 30.06.2023.

Shpallja e renditjes së konkurrentëve për lëvizjen paralele dhe paralele të detyrueshme, sipas rendit zbritës do të bëhet më datë 01.09.2023;

Vlerësimi i dojesve të kandidatëve për lëvizje paralele, do të bëhet brenda muajit gusht të këtij viti.

Njoftimi do të bëhet në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Afati për ankim është 3(tre) ditë duke filluar nga data 01.09.2023.

K R Y E T A R I

